



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 05 REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ  
NGA PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**KËRKUES:** Partia Komuniste e Shqipërisë.

**OBJEKT:** Kundërshtimi i Vendimit nr.9 datë 25.05.2019 të KZAZ nr.45 "Për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Belsh"

**BAZË LIGJORE:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68; 70; 71; 72 73; 124, 143, pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,

**VËREN**

Partia Komuniste e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.05, datë 28.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i Vendimit nr.9, datë 25.05.2019, të KZAZ nr. 45 "Për mosregjistrimin kandidatit për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 30.05.2019, ora 18:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.03 regj., sipas objektit të sipërcituar.



**Nr. 731 i Vendimit Data 30.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit**  
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 05, datë 28.05.2019, të paraqitur nga Partia  
Komuniste e Shqipërisë

Në mbledhjen e datës 30.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 05 subjekti ankues i vetëm, është Partia Komuniste e Shqipërisë.

Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 28.05.2019 pretendon se:

1. Me vendimin nr.9, datë 25.05.2019, të KZAZ nr. 45 "Për mosregjistrimin kandidatit për kryetar bashkie Belsh, propozuar nga subjekti Partia Komuniste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.
2. Subjekti zgjedhor Partia Komuniste e Shqipërisë më datë 13.05.2019 ka depozituar pranë KQZ formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Belsh.
3. KZAZ-ja nr.45 me vendimin nr.09 prot., datë 25.05.2019 i ka vendosur mosregjistrimin e kandidati për kryetar bashkia Belsh, për shkak të mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Subjekti Zgjedhor pretendon se në asnjë moment nuk është vënë në dijeni për mungesën e formularit të vetëdeklarimit deri më datë 22.06.2019 kur është njoftuar për mosregjistrimin kandidatit për kryetar bashkia Belsh, z. Jashar Elezi. Pas këtij njoftimi ankuesi pretendon së është paraqitur përsëri pranë KQZ-së dhe ka ridepozituar formularin e vetëdeklarimit edhe një herë.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 afati i fundit i përlllogaritur për dorëzimin e dokumentacionit ishte data 13 maj 2019.

Vendimi i sipërcituar i KZAZ-së nr.45, Bashkia Belsh, për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar bashkia Belsh, propozuar nga subjekti Partia Komuniste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit së formularit të vetëdeklarimit sipas ankuesit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palës ankuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për nevoja të hetimit administrativ, vendosi të administrojë kryesisht në përputhje me nenin 136, pika 2 dokumentacionin e depozituar nga Partia Komuniste e Shqipërisë pranë zyrës së protokollit të KQZ-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se me shkesën me datë 13.05.2019, Partia Komuniste e Shqipërisë ka depozituar në KQZ listën për këshillin e bashkisë Belsh. Në datë 22.05.2019 Partia Komuniste e Shqipërisë ka depozituar formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Belsh, z. Jashar Elezi dhe është protokolluar nga KQZ në datë 23.05.2019.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", subjekti Partia Komuniste e Shqipërisë ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, të kandidatit për kryetar bashkie si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit Formularit të vetëdeklarimit, rezulton se ky dokumentacion është depozituar në KQZ, brenda aftit të parashikuar nga neni 73, pika 2 i Kodit zgjedhor për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit. KQZ vendosi administrimin e formularit të vetëdeklarimit si prove dhe ta pranojë si pjesë integrale të dokumentacionit të kandidimit të cilin kandidati, ankues e ka depozituar në KZAZ.



Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". KQZ në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015" është në proces verifikimi të formularëve të vetëdeklarimit për t'ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Gjyqësore si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 30.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar z. Jashar Elezi, në Bashkinë Belsh, të depozituar nga Partia "Komuniste e Shqipërisë" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Komuniste e Shqipërisë është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 143, pika 1, germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të vendosë ndryshimin e vendimit nr.9, datë 25.05.2019, të KZAZ nr. 45 "Për mosregjistrimin kandidatit për kryetar bashkie Belsh, propozuar nga subjekti Partia Komuniste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68;70; 71; 72; 73; 124, 143, pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

#### **V E N D O S I:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 10, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 "Për mos regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Belsh" dhe regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Belsh z. Jashar Elezi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 731 i Vendimit Data 30.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit**  
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 05, datë 28.05.2019, të paraqitur nga Partia  
Komuniste e Shqipërisë